

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7873  
E premte, 30 gusht 2024  
Çmimi 0.50

Presidentja Osmani  
dekretin 31 gjyqtarë me  
mandat fillestar | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", PAL LEKAJ | FAQE 4-5

## POLITIKAT E QEVERISË KURTI KRIJUAN MJEDIS TË PASIGURT

- Do të fokusohemi në rimëkëmbjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës, përmirësimin e infrastrukturës dhe rritjen e mirëqenies sociale



Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e AAK-së, Pal Lekaj, ka vlerësuar se zhvillimet e fundit politike dhe të sigurisë në vend janë shqetësuese. Në intervistën dhënë për gazetën "Epoka e re", Lekaj ka thënë se qeveria Kurti ka dështuar të ofrojë zgjidhje të qëndrueshme për problemet kryesore me të cilat ballafaqohet vendi. Sa i përket hapjes së urës mbi lumin Ibër, Lekaj ka thënë se një gjë e tillë duhet të bëhet në koordinim me komunitetin lokal dhe atë ndërkombëtar. Deputeti i AAK-së ka paralajmëruar se kjo parti do të ofrojë platformë të qartë për zgjedhjet e 9 shkurtit të vitit 2025. Ai ka thënë se do të fokusohen në rimëkëmbjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës, përmirësimin e infrastrukturës dhe rritjen e mirëqenies sociale për të gjithë qytetarët

**KRYEDIPLOMATI I SHQIPËRISË POROSIT KOSOVËN TË KONSULTOHET ME ALEATËT RRETH URËS**

F.3



**KURTI: PO PËRGATITEMI PËR GËRMIM NË KOZHLE TË SERBISË NË KËRKIM TË TË ZHDUKURVE**

F.7



### AKTUALE



**ANËTARËSIMI I KOSOVËS NË NATO DO TË KONTRIBUOJË PËR SIGURINË E GJITHË RAJONIT**

F.5

**KRASNIQI I THOTË SARRAZIT SE PDK-JA ËSHTË PËR BASHKËPUNIM TË MIRË ME PARTNERËT NDËRKOMBËTARË**

F.5

**GJYQTARI HASAN KRYEZIU ÇAKTOHET NËNKRYETARI I GJYKATËS KOMERCIALE**

F.7

### EKONOMI



**NËNSHKRUHEN KONTRATAT MË PËRFITUESIT NGA PROGRAMI PËR ZHVILLIM RAJONAL TË BALANCUAR 2024**

F.8

**HAPET DEGA E POSTËS SË KOSOVËS NË MITROVICË TË VERIUT**

F.8

### SPORT



**KOSOVA PËR HERË TË PARË PJESË E LOJËRAVE PARALIMPIKE**

F.10

**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mobi: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



# Anëtarësimi i Kosovës në NATO do të kontribuojë për sigurinë e gjithë rajonit

**PRISHTINË, 29 GUSHT** - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të enjten në takim ndihmësekretarin e përgjithshëm të NATO-s për operacione, Thomas Goffus.

Sipas presidentes Osmani, Kosova mbetet e përkushtuar për bashkëpunim të vazhdueshëm me NATO-n dhe KFOR-in për adresimin e sfidave në fushën e sigurisë.

Më tej, presidentja Osmani falënderoi NATO-n për angazhimin e deritashëm për paqe, siguri dhe stabilitet dhe në këtë kontekst ritheksoi objektivin strategjik të Kosovës për integrim në komunitetin euroatlantik, duke shprehur besimin se anëtarësimi në NATO do të

kontribuojë për sigurinë dhe stabilitetin e gjithë rajonit.

Në takim me ndihmësekretarin Goffus, ndër të tjera u diskutua edhe për çështjen e hapjes së urës së Ibrit. Presidentja Osmani ka përsëritur qëndrimin për hapjen e urës, porse ka potencuar rëndësinë e mirëmbajtjes së komunikimit, koordinimit dhe thellimit të bashkëpunimit në mes të institucioneve tona dhe partnerëve tanë të sigurisë, veçanërisht me NATO-n, për hartimin e një plani të përbashkët të zbatimit për hapjen e urës.

Hapjen e urës, presidentja Osmani e ka cilësuar si një veprim në funksion të normalizimit dhe integritetit në interes të të gjithë qytetarëve, pa dallim etnie.



## Paditet shefi i Telegramit dhe i ndalohet largimi prej Francës

**PARIS, 29 GUSHT** - Shefi i Telegramit, Pavel Durov, është paditur për dështim të ndalimit të përmbajtjes ekstremiste dhe ilegale në platformën e popullarizuar për mesazhe, dhe do të jetë nën mbikëqyrje të autoriteteve, ka thënë Zyra e Prokurorit në Paris.

Ai detyrohet të paraqitet në stacionin policor dy herë në javë dhe i është ndaluar largimi prej Francës, ka thënë Zyra e Prokurorit përmes një deklarate në X – platformë e njohur më parë si Twitter.

Gjyqtarët hetues në Paris kanë kërkuar që shefi i Telegramit të paguajë 5 milionë euro si garanci. Durov, i lindur në Rusi, por që ka edhe shtetësi franceze, është ndaluar në aeroportin Le Bourget në Paris, më 24 gusht, dhe është marrë në pyetje.

Sipas raportimeve të mediave franceze, ai është ndaluar me kërkesë të një departamenti



special brenda Ministrisë së Brendshme të Francës, e cila angazhohet për hetim të krimeve kundër të miturve.

Dyshohet që platforma e udhëhequr prej Durovit është duke u përdorur për të siguruar materiale për abuzim seksual të fëmijëve dhe trafikim të drogës, dhe që Telegrami ka refuzuar t'i dorëzojë informacionet apo dokumentet që kanë kërkuar

hetuesit.

Zyra e Prokurorit ka thënë se akuzat ndaj tij nënkuptojnë që nëse shpallet fajtor, mund të dënohet me 10 vjet burgim dhe 500.000 euro gjobë.

Akuzat preliminare, sipas ligjit francez, nënkuptojnë që prokurorët kanë arsye për të besuar që është kryer një krim, mirëpo kanë nevojë për më shumë hetime.

Telegrami ka thënë përmes një deklarate më 25 gusht se Durov nuk ka asgjë për të fshehur, dhe që është absurde të ndalohet shefi i kompanisë për abuzimet që ia ka bërë dikush platformës.

Përveç shtetësisë ruse dhe franceze, Durov ka edhe pasaporta të Emirateve të Bashkuara Arabe dhe të një shteti të vogël në Karaibe.

Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, ka thënë më 27 gusht se dyshimet kundër Durovit janë “shumë serioze” dhe që “duhen dëshmi për t’u vërtetuar që janë aq serioze”, për t’i zhdukur dyshimet e shumë njerëzve që besojnë se miliarderi është arrestuar mbi motive politike. Presidenti francez, Emanuel Macron, ka thënë më 26 gusht se arrestimi i Durovit është kryer vetëm në bazë të hetimeve të pavarura.

Telegrami është themeluar nga Durov dhe vëllai i tij, më 2013, pas

shtypjes që u ka bërë Qeveria ruse protestave masive pro-demokracisë në Moskë, më 2011 dhe 2012.

Një prej avantazhe të platformës është që bisedat janë të sigurta dhe garantohet anonimiteti i përdoruesve.

Në grupe nuk shihet numri kontaktues i një personi.

Durov pati thënë në disa intervista se Telegrami synon të jetë “platformë neutrale” dhe jo “lojtare në gjeopolitikë”.

Megjithatë, kritikët në Ukrainë besojnë se në platformë përhapen dezinformata dhe lehtësohen veprime ilegale.

Disa e akuzojnë Telegramin se ka lidhje me shtetin rus dhe ka kontribuar në përpjekjet e tij për luftë në Ukrainë.

Telegrami, tani me bazë në Dubai, ka më shumë se 900 milionë përdorues dhe shumica e tyre janë në Rusi, Ukrainë dhe ish-republika tjera sovjetike.

## Holanda i jep leje Ukrainës t’i përdorë F16-shat në territorin rus

**AMSTERDAM, 29 GUSHT** - Holanda i ka dhënë leje Ukrainës t’i përdorë avionët luftarakë F-16 në territorin rus, të cilët i ka dhuruar kohë më parë. Lajmi u bë i ditur nga komandanti i Forcave të Armatosura të Holandës, Onno Eichelsheim. “Ne nuk kemi vendosur kufizime në përdorimin dhe gamën e F16-shave, nëse zbatohen ligjet e luftës”, tha Eichelsheim për transmetuesin publik NOS.

Duke folur nga Shtetet e Bashkuara, gjenerali Eichelsheim tha se kolegët amerikanë janë pajtuar “pjesërisht” me qëndrimin e tij.

Holanda ia ka dhuruar Ukrainës 24 avionë luftarakë F-16.

Eichelsheim nuk ka dashur të tregojë nëse Ukraina është duke e përdorur tani ndonjë prej tyre.

F16-shat, të ndërtuar nga Lockheed Martin, kanë qenë dëshirë e kamotshme e Ukrainës, për shkak të forcës së tyre

shkatërruese. Ky avion mund të bartë bomba, predha dhe raketa.

Pilotët ukrainas janë trajnuar se si t’i përdorin F16-shat nga partnerët perëndimorë për muaj të tërë.

Ushtria ukrainase është detyruar të varet nga një tufë e vogël e avionëve luftarakë të epokës sovjetike për ta zmbarsur pushtimin rus, që nisi më 2022.

Zyrtarët ukrainas i shohin avionët F-16 si një përditësim jetik për Forcën e tyre Ajrore.





## Presidentja Osmani dekreton 31 gjyqtarë me mandat fillestar

PRISHTINË, 29 GUSHT - Presidentja Vjosa Osmani, me propozim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka dekretuar të enjten 31 gjyqtarë me mandat fillestar. Në ceremoninë e betimit para presidentes së Republikës, gjyqtarët e rinj

janë betuar se: “do t'i qëndrojnë besnik Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ligjeve në fuqi dhe do të respektojnë rregullat e etikës profesionale, si dhe do të kryejnë me besnikëri në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të

paanshme detyrat e tyre”. Presidentja Osmani ka potencuar se integriteti, pavarësia, paanshmëria dhe profesionalizmi i gjyqtarëve janë elemente thelbësore për një sistem të drejtësisë që garanton barazi për të gjithë dhe besim qytetar.



## Kryediplomati i Shqipërisë porosin Kosovën të konsultohet me aleatët rreth urës



TIRANË, 29 GUSHT - Ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Igli Hasani, i ka bërë thirrje Kosovës që vendimin për hapjen e urës kryesore mbi lumin Ibër ta marrë në koordinim me vendet dhe organizatat që kanë ndihmuar në pavarësimin e Kosovës.

Ai i ka bërë këto deklarata gjatë një bashkëbisedimi me gazetarët, pas përfundimit të konferencës tre ditore “Tirana Diplo2024”. “Kemi qenë të qartë dhe këmbëngulës se prioriteti i politikës së Jashtëme është Kosova, dhe duke qenë kështu, gjithnjë u kemi thënë

motrave dhe vëllezërve tanë në Prishtinë se që të gjithë hapat dhe vendimet që ndërmarrin, duhet t'i diskutojnë në radhë të parë me ata që i duan shumë dhe i kanë për zemër”, tha Hasani, pasi është pyetur për qëndrimin e Tiranës zyrtare sa i përket urës mbi Ibër.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë më 28 gusht se është duke i bërë të gjitha konsultimet e nevojshme me aleatët për hapjen e urës.

Qeveria e Kosovës pati rritur përpjekjet në fillim të gushtit për hapje të kësaj ure, e cila ndan

Mitrovicën Jugore me shumicë shqiptare me Mitrovicën Veriore me shumicë serbe - është e hapur për këmbësorët.

Ura është e hapur për qarkullim të këmbësorëve, por jo për vetura.

Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, pati paralajmëruar ato ditë kundër hapjes së urës, meqë një veprim i tillë rrezikon ushtarët amerikanë. Edhe misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, i cili ka prezencë të përhershme mbi urë, pati thënë se nuk do të hezitohet të veprojë, nëse rrezikohet siguria në atë

pjesë.

Mes tjerash, ministri Hasani ka thënë se Tirana tashmë ka nisur përgatitjet për samitin e NATO-s të vitit 2027, për të cilin kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se do të mbahet në kryeqytetin e vendit që udhëheq.

Një zyrtar i NATO-s, i ka thënë Radios Evropa e Lirë se samiti i kësaj organizate, më 2025, do të mbahet në Hagë prej 24 deri më 26 qershor, dhe do të pasohet me një tjetër samit në Turqi.

Ai ka thënë se nuk ka asgjë për të

shtuar për lokacionet e samiteve tjera të NATO-s. “Jemi në fazën e përgatitjeve të brendshme. Kemi nisur identifikimin e ambienteve, fondeve dhe njerëzve që e bëjnë të mundur. Kjo tregon se Shqipëria është partner i rëndësishëm dhe aleat i domosdoshëm në gjithë përpjekjen e organizatës së Atlantikut të Veriut për atë që ndodh sot dhe në fokus zhvillimet e fundit”, ka thënë mes tjerash Hasani.

Samiti i sivjetmë i NATO-s është mbajtur nga 9 deri më 11 korrik në Uashington.

## Dy qytetarë nga Ferizaj dorëzojnë në polici para të gjetura

FERIZAJ, 29 GUSHT - Në dy raste të ndara dy qytetarë nga Ferizaj kanë gjetur para në rrugë dhe ato i kanë dorëzuar në stacionin e policisë në Ferizaj. “Me datën 21.08.2024 rreth orës 21:00, tek sheshi ‘Hyre Emiri’ në Ferizaj, qytetarja I. Hajredini ka gjetur një shumë të caktuar të parave dhe ato i ka dorëzuar në

stacionin e policisë në Ferizaj. Me datën 28.08.2024, rreth orës 20:00 në Ferizaj, qytetarja nga Ferizaj F. Maloku ka gjetur një shumë të caktuar të parave dhe ato i ka dorëzuar në stacionin e policisë në Ferizaj. Lusim pronarët e vërtetë të parave të humbura të paraqiten në stacionin e policisë në Ferizaj nga e hëna deri të

premtën, prej orës 08:00-16:00 dhe ti tërheqin paratë e tyre të humbura. Me këtë rast Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj i ka falënderuar dy qytetarët: I. Hajredini dhe F. Maloku për gjestin e tyre human dhe shembullorë me rastin e dorëzimit të parave të gjetura në stacionin e policisë”, ka njoftuar Policia







FLET PËR "EPOKËN E RE", PAL LEKAJ

# Politikat e qeverisë Kurti krijuan mjedis të pasigurt

**- Do të fokusohemi në rimëkëmbjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës, përmirësimin e infrastrukturës dhe rritjen e mirëqenies sociale**

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e AAK-së, Pal Lekaj, ka vlerësuar se zhvillimet e fundit politike dhe të sigurisë në vend janë shqetësuese. Në intervistën dhënë për gazetën "Epoka e re", Lekaj ka thënë se qeveria Kurti ka dështuar të ofrojë zgjidhje të qëndrueshme për problemet kryesore me të cilat ballafaqohet vendi. Sa i përket hapjes së urës mbi lumin Ibër, Lekaj ka thënë se një gjë e tillë duhet të bëhet në koordinim me komunitetin lokal dhe atë ndërkombëtar. Deputeti i AAK-së ka paralajmëruar se kjo parti do të ofrojë platformë të qartë për zgjedhjet e 9 shkurtit të vitit 2025. Ai ka thënë se do të fokusohen në rimëkëmbjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës, përmirësimin e infrastrukturës dhe rritjen e mirëqenies sociale për të gjithë qytetarët

tillë të merret në mënyrë të njëanshme dhe pa konsultim të duhur me komunitetin lokal dhe partnerët ndërkombëtarë. Prioriteti ynë duhet të jetë ruajtja e paqes dhe sigurisë për të gjithë qytetarët, dhe çdo hap që rrezikon këto vlera duhet të trajtohet me kujdes të veçantë", ka thënë Lekaj. Në këtë intervistë, Lekaj ka folur edhe për zgjedhjet parlamentare të cilat do të mbahen më 9 shkurt të vitit 2025.

Lekaj ka deklaruar se AAK-ja do të ofrojë një platformë të qartë për këto zgjedhje. "Ne do të fokusohemi në rimëkëmbjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës, përmirësimin e infrastrukturës, dhe rritjen e mirëqenies sociale për të gjithë qytetarët e Kosovës. Po ashtu, do të angazhohemi për të forcuar sundimin e ligjit dhe për të siguruar që të gjithë qytetarët të ndihen të përfaqësuar dhe të sigurt në vendin e tyre. Oferta jonë do të jetë e bazuar në nevojat reale të qytetarëve dhe në përvojën tonë të gjatë në qeverisje dhe opozitë", ka thënë Lekaj.

Duke iu referuar zgjedhjeve parlamentare, Lekaj ka thënë se është e pritshme që qeveria Kurti të marrë vendime populiste siç ishte ai për rritjen e pagës minimale. "Duke qenë se jemi në një periudhë parazgjedhore, është e mundur që qeveria të marrë vendime të tjera populiste si rritja

e pagave dhe pensione për të fituar simpatinë e votuesve. Ne e dimë se këto vendime, shpesh herë, nuk bazohen në qëndrueshmëri ekonomike dhe janë të orientuara më shumë drejt përfitimeve afatshkurtra politike sesa drejt të mirës afatgjate të vendit", është shprehur Lekaj.

**"Epoka e re": Z. Lekaj si i vlerësoni zhvillimet e fundit politike dhe të sigurisë në vend?**

**Lekaj:** Zhvillimet e fundit politike dhe të sigurisë në vend janë të shqetësuese. Kemi parë rritje të tensioneve dhe një mungesë të qartësisë në drejtimin e qeverisë. Politikat e fundit të qeverisë kanë krijuar një mjedis të pasigurt dhe të polarizuar, duke dështuar të ofrojnë zgjidhje të qëndrueshme për problemet kryesore të vendit. Situata e sigurisë në vendi kërkon një qasje më të kujdesshme dhe një angazhim të fortë për dialog dhe bashkëpunim, që fatkeqësisht ka munguar.

**"Epoka e re": Po punën e qeverisë si e vlerësoni gjatë këtyre viteve?**

**Lekaj:** Puna e qeverisë gjatë këtyre viteve ka qenë e paqëndrueshme dhe shpesh e pakoordinuar. Ka munguar transparenca dhe llogaridhënia në shumë vendime të rëndësishme. Në vend që të adresojë problemet reale të qytetarëve, qeveria shpeshherë ka ndërhyrë me veprime të

pamenduara që kanë krijuar ndasi dhe pakënaqësi. Për më tepër, politikat ekonomike dhe sociale nuk kanë arritur të sjellin përmirësimet e premtuara, duke lënë shumë qytetarë të zhgënjyer.

**"Epoka e re": Qeveria dhe eksponentët e saj kanë paralajmëruar hapjen e urës së Ibrit. Ky paralajmërim ka ngjallur reagime të shumta sidomos nga faktori ndërkombëtar. Cili është qëndrimi i partisë që përfaqësoni sa i përket kësaj teme?**

**Lekaj:** Partia që unë përfaqësoj, AAK, beson se hapja e urës së Ibrit duhet të bëhet vetëm nëse plotësohen të gjitha kushtet e sigurisë dhe me pëlqimin e të gjithë palëve të përfshira. Nuk mund të lejojmë që një vendim i tillë të merret në mënyrë të njëanshme dhe pa konsultim të duhur me komunitetin lokal dhe partnerët ndërkombëtarë. Prioriteti ynë duhet të jetë ruajtja e paqes dhe sigurisë për të gjithë qytetarët, dhe çdo hap që rrezikon këto vlera duhet të trajtohet me kujdes të veçantë.

**"Epoka e re": Zgjedhjet parlamentare do të mbahen më 9 shkurt të vitit të ardhshëm. Cila është oferta e AAK-së për këto zgjedhje?**

**Lekaj:** AAK-ja do të ofrojë një platformë të fortë dhe të qartë për zgjedhjet e ardhshme. Ne do të

EPOKA E RE

Lirim GECI

PRISHTINË, 29 GUSHT - Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, ka thënë se zhvillimet e fundit politike dhe të sigurisë në vend janë shqetësuese.

Në intervistën dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se qeveria Kurti ka dështuar të ofrojë zgjidhje të qëndrueshme për problemet kryesore të vendit. "Puna e qeverisë gjatë këtyre viteve ka qenë e paqëndrueshme dhe shpesh e pakoordinuar. Ka

munguar transparenca dhe llogaridhënia në shumë vendime të rëndësishme. Në vend që të adresojë problemet reale të qytetarëve, qeveria shpeshherë ka ndërhyrë me veprime të pamenduara që kanë krijuar ndasi dhe pakënaqësi", ka thënë Lekaj.

Në këtë kontekst, Lekaj ka theksuar se situata e sigurisë në vend kërkon qasje të kujdesshme. Sa i përket hapjes së urës mbi lumin Ibër, Lekaj ka thënë se një gjë e tillë duhet të bëhet në koordinim me komunitetin lokal dhe atë ndërkombëtar. "Nuk mund të lejojmë që një vendim i



## Haradinaj, Kurtit: Askush më nuk u beson shifrave tua, mashtrimi nuk kalon

PRISHTINË, 29 GUSHT - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj ka kritikuar qeverisjen Kurti, duke thënë se vendi nuk ndërtohet e as qeveriset gjithmonë me mashtrim.

Kryetari i AAK-së në një postim në "Facebook" ka shkruar se askush më nuk u beson shifrave të qeverisë Kurti. "Mashtrimi s'kalon! Nuk ndërtohet vendi e as nuk qeveriset gjithmonë me mashtrim. Nëse nuk ta kanë thënë dhe nëse nuk e din vetë, çka unë dyshoj, jeta e qytetarit të Kosovës nuk është duke u përmirësuar por është duke u varfëruar. Askush nuk ju beson më shifrave tua e edhe militantët që të rrinë përreth e dinë që je duke mashtruar dhe po abuzon me numra për zhvillim ekonomik dhe punësim. Nëse e ke rritë buxhetin për 35%, pse të paktën s'po i rritë pagat e pensionet, bile të paktën 25%? Ndoshta po pret fushatën zgjedhore e pastaj ta realizosh rritjen se të duhet për vota. S'ka lidhje. Përfito me këtë formë të ulët mashtrimi por veç

ngriti pagat sepse njerëzit e këtij vendi janë dhe kanë shumë nevojë për rritje pagash e pensionesh. Çdo ekspert buxheti e din që ke mundësi për rritje deri në 25-30% pa asnjë problem qysh sot", ka thënë Haradinaj.

Ai i është drejtuar kryeministrit në emër, duke theksuar se për katër vite nuk është krijuar asnjë vlerë e re. "Albin, në Kosovë për katër vite nuk është krijuar asnjë vlerë e re, as politike as ekonomike dhe nuk ka progres në asnjë sferë të jetës. Kemi sanksione nga BE dhe kemi humbur për një vit rreth 500 milionë EURO veç nga këto masa. E ke dëmtuar rëndë pozicionin e Kosovës në integritime euro-atlantike dhe askush nga vendet aleate nuk të sheh si partner por si person që duhet menaxhuar. Ke dëmtuar raportet me investitorë dhe ke mbajtur ata larg nga Kosova. Agjencioni i Statistikave që është pjesë e zyrës së Kryeministrit të ka tregu që 211, 749 qytetarë e kanë braktisë Kosovën për 4 vite sa ti ke qeverisë. Nëse flet me të rinj,



shumë prej tyre janë duke aplikuar dhe duke u përpjekur që të ikin dikah. Nuk ke asnjë ide asnjë koncept me ndihmë vendin përveç populizmit, fjalëve të bukura dhe veprimeve boshe",

është shprehur Haradinaj, duke kërkuar nga Kurti që të mos abuzojë me statistika. "Mos abuzo me statistika e mos mashtro. Kërkah s'është drejtimi që i ke dhënë Kosovës. Me trendet

që i ke nuk besoj që të duhet fitorja në zgjedhje. Nuk përfiton Kosova e jam i sigurt që as ti, sepse 'zullumi këputet për së trashi' thotë populli", ka theksuar Haradinaj.

## Krasniqi i thotë Sarrazin se PDK-ja është për bashkëpunim të mirë me partnerët ndërkombëtarë



PRISHTINË, 29 GUSHT - Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi së bashku me Bedri Hamzën dhe Vlora Çitakun kanë pritur të enjten në selinë e partisë përfaqësuesin Special të Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin. Bashkë diskutuan për zhvillimet e fundit politike në rajon, me theks të veçantë ato në Kosovë. Krasniqi emisar Sarrazin e ka njoftuar se Partia Demokratike e Kosovës është angazhuar çdo ditë, në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, të jap kontributin e saj të parzervë për

ruajtjen e interesit të shtetit tonë. "Për PDK-në, bashkëpunimi i mirë me partnerët ndërkombëtarë në funksion të zhvillimit dhe integritimit euro-atlantik të Kosovës është tejet i rëndësishëm. Në këtë drejtim, PDK-ja mbështetë të gjitha nismat e mirëfillta të cilat rrisin dhe fuqizojnë bashkëpunimin konstruktiv rajonal - si hap konkret drejt përafrimit të rajonit me Bashkimin Evropian. Emisar Sarrazin e falënderova për kontributin e vazhdueshëm të Gjermanisë për Kosovën", ka thënë Krasniqi pas takimit.

fokusohemi në rimëkëmbjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës, përmirësimin e infrastrukturës, dhe rritjen e mirëqenies sociale për të gjithë qytetarët e Kosovës. Po ashtu, do të angazhohemi për të forcuar sundimin e ligjit dhe për të siguruar që të gjithë qytetarët të ndihen të përfaqësuar dhe të sigurt në vendin e tyre. Oferta jonë do të jetë e bazuar në nevojat reale të qytetarëve dhe në përvojën tonë të gjatë në qeverisje dhe opozitë. Si deputet aktual kam detyrimin ndaj qytetarëve të cilët më kanë zgjedhur dhe do të vazhdoj të punoj për të mirën e vendit. Sa i përket kandidatit të tme të ardhshme, ky është një vendim që do të merret në koordinim me strukturat e partisë dhe në bazë të asaj që është më e mira për AAK-në dhe qytetarët e Kosovës.

"Epoka e re": Ku besoni se do ta renditin qytetarët partinë tuaj në

këto zgjedhje?

**Lekaj:** Besojmë që qytetarët do të njohin dhe vlerësojnë përkushtimin e AAK-së për një qeverisje të drejtë dhe transparente. Në këtë frymë, jemi të bindur se qytetarët do të na rendisin si një opsion të besueshëm për t'i përfaqësuar interesat e tyre dhe për të udhëhequr vendin drejt një të ardhmeje më të mirë. Puna jonë e palodhur në shërbim të qytetarëve do të reflektohet në mbështetjen që do të marrim në zgjedhjet e ardhshme.

"Epoka e re": Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për rritjen e pagës minimale prej 350 euro. Si e vlerësoni këtë vendim?

**Lekaj:** Rritja e pagës minimale është një hap pozitiv për shumë punonjës që luftojnë për të përmbushur nevojat bazë, por ky vendim vjen vonë dhe nuk adreson të gjitha sfidat ekonomike të qytetarëve. Qeveria duhet të



ketë një qasje më gjithëpërfshirëse dhe të kujdesshme për të siguruar

që rritja e pagave të shoqërohet me rritjen e produktivitetit dhe

zhvillimin ekonomik, në mënyrë që të mos krijohet inflacion apo presion shtesë mbi bizneset e vogla.

"Epoka e re": A prisni vendime të tjera të kësaj qeverie në fund të mandatit, duke përfshirë rritjen e pagave dhe pensione?

**Lekaj:** Duke qenë se jemi në një periudhë parazgjedhore, është e mundur që qeveria të marrë vendime të tjera populiste si rritja e pagave dhe pensione për të fituar simpatinë e votuesve. Ne e dimë se këto vendime, shpesh herë, nuk bazohen në qëndrueshmëri ekonomike dhe janë të orientuara më shumë drejt përfitimeve afatshkurtra politike sesa drejt të mirës afatgjate të vendit. Si opozitë, do të jemi vigjilentë dhe do të kërkojmë që çdo vendim të merret me përgjegjësi dhe transparencë, duke pasur parasysh interesin e qytetarëve dhe qëndrueshmërinë ekonomike të vendit.



## Latifi thotë se janë bërë përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor në Rahovec

RAHOVEC, 29 GUSHT - Kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, së bashku me drejtorin e DKA-së dhe me zyrtarë të tjerë, zyrtarin nga Stacioni Policor në Rahovec, mbajtën takim me drejtorët dhe me zëvendësdrejtorët e shkollave, me pedagoget, me

psikologet, me koordinatorët për cilësi dhe me kryetarët e këshillave drejtuese të shkollave. "Diskutuam mbi sigurinë në shkolla, për fillimin e vitit të ri shkollor, për mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor dhe për mbikëqyrjen sa më efektive të

tij. Kërkova nga drejtuesit dhe i gjithë personeli edukativ, arsimor e pedagogjik, nga punonjësit teknik, të rrisin përkushtimin për një proces të rregullt mësimor dhe për ngritjen e cilësisë në arsim. Gjithashtu, u fol për ecurinë e projekteve në arsim dhe për

planet e mëtejshme. Ne mbetemi të përkushtuar për bashkëpunim të vazhdueshëm në funksion të përmirësimit të kushteve, për rritjen e cilësisë dhe për mbarësi dhe suksese në vitin e ri mësimor 2024-2025", ka bërë me dije Latifi.



## INPO: Kundërshtimet e Komunës së Gjilanit ndaj vendimit të OShP-së nuk kanë bazë ligjore

PRISHTINË, 29 GUSHT - Organizata INPO ka përcjell me kujdes kundërshtimet e Komunës së Gjilanit ndaj vendimit të nxjerrë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), në lidhje rastin e Stadiumit të Qytetit të Gjilanit.

Komuna e Gjilanit ka parashtruar kërkesë pranë OSHP-së për shfuqizimin e vendimit të këtij të fundit, në bazë të të cilit është anuluar procedura e prokurimit për "Renovimin e Stadiumit të Qytetit të Gjilanit".

INPO vlerëson se qasjet e tilla të reagimit të autoriteteve kontraktuese, të cilat kanë qenë të pranishme edhe në të kaluarën, jo vetëm që nuk kanë bazë juridike për t'u praktikuar, por ato mund të shihen edhe si forma të ndikimit ndaj pavarësisë profesionale të autoriteteve kompetente në fushën e prokurimit publik.

Legjislacioni i zbatueshëm në fushën e prokurimit publik, në mënyrë të qartë, ka specifikuar të

drejtat ligjore të palëve pjesëmarrëse në një proces të tenderimit, mjetet juridike, e deri tek karakteri juridik i akteve administrative të nxjerra.

Në rastin konkret, Komuna e Gjilanit, si autoritet kontraktues do duhej të kishte të qartë se Vendimi Nr. 2024/0521, i datës 09.08.2024, i shpallur nga OSHP, paraqet një akt administrativ përfundimtar dhe detyrues për autoritetin kontraktues. Ky vendim është i karakterit obligativ për komunën, dhe se e njëjta nuk mund të ndërmarrë asnjë veprim përkitazi me çështjen lëndore, dhe se pasojat e aktit shprehen në anulimin e gjithë procesit të zhvilluar.

Ligji për Prokurimin Publik, si ligj special për proceset e prokurimit publik, rregullon në mënyrë të detajuar procedurën e ankimimit të palëve pjesëmarrëse. Kjo procedurë është sqaruar më tej përmes Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Sikurse Ligji për Prokurimin Publik, ashtu



edhe Rregullorja përcaktojnë dy nivele të ankimimit: mjetin e kundërshtimit, që shqyrtohet brenda autoritetit kontraktues, si shkallë e parë e ankimimit, dhe ankesën që mund të dorëzohet pranë OSHP-së, si shkallë dytë dhe përfundimtare e ankimimit.

Në vështrim të dispozitave ligjore që rregullojnë procedurat e ankimimit ndaj aktit përfundimtar administrativ të prokurimit publik, INPO vlerëson se Komuna e Gjilanit, si autoritet kontraktues, nuk ka vepruar në përputhje me

dispozitat e parashikuara në Ligjin për Prokurimin Publik. Konkretisht, komuna ka zgjedhur të kontestojë vendimin përfundimtar të OSHP-së duke u referuar në nenet 53, 57.1 dhe 98 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Referenca në dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative për të kërkuar anulimin e vendimit nuk është rruga përmes së cilës kundërshtohet ky vendim i OSHP-së.

Në këtë kontekst, forma e vetme

ligjore për të kundërshtuar një proces të tillë administrativ, do të ishte e mundshme vetëm përmes konfliktit administrativ, që mund të inicohet pranë Gjykatës Themelore për Çështjet Administrative, sipas nenit 119 të Ligjit për Prokurimin Publik, dhe nenit 10 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Andaj, organizata INPO konsideron se autoritetet kontraktuese duhet mbrojnë interesat e tyre juridike vetëm brenda kornizës ligjore të lejueshme dhe të evitojnë çfarëdo forme të presionit që mund të ndikoj në punën e institucioneve të pavarura. Respektimi i procedurave të prokurimit publik, pavarësisht pasojave, kërkohet të jetë parim bazë i punës së organeve shtetërore, përfshirë edhe komunave, me qëllim që të evitohen proceset të cilat nuk kanë bazë të mirëfilltë të ligjshmërisë, transparencës dhe që mund të dëmtojnë interesat legjitime të palëve pjesëmarrëse.

## KEDS-i investon në fshatin Saraishtë të Ferizajt mbi 150 mijë euro



FERIZAJ, 29 GUSHT - Rrjeti elektrik komplet i ri ka plotësuar pamjen e fshatit të vogël, por shumë piktoresk të Ferizajt, Saraishtës. I shtrirë në një fushë kodrinore të gjelbëruar dhe të pastër, me rrugë dhe infrastrukturë përcjellëse komplet të re, të plotësuar edhe me shtyllat dhe përcuesit e rinj, fshati ka marrë pamjen e një lokaliteti evropian në të gjitha aspektet.

Projekt i linjës ajrore që me degëzimet e rrjetit nëpër rrugicat e

fshatit që shtrihet shumë afër Ferizajt, arrin një gjatësi prej katër kilometrash. Aty tashmë është bërë vendosja e 80 shtyllave të reja të betonit të tensionit të mesëm dhe atij të ulët. Përpos këtyre është bërë edhe instalimi i një transformatori të ri e me kapacitet të mjaftueshëm të furnizimit me energji elektrike, si dhe një trafo shtyllë, 58 ormanë dhe stabilimente të tjera të nevojshme. Vlera totale e këtij projekti është mbi 150 mijë euro, prej të cilit

përfitojnë enkas afër 400 banorë sa numëron ky fshat. Saraishtasit janë shprehur mjaft të lumtur për këtë investim, që ka kompletuar infrastrukturën dhe do t'u ofrojë atyre shërbime të kualitetit të lartë sa i përket distribuimit dhe furnizimit me energji elektrike. Projekti Saraishta është vetëm njëri nga 21 projektet që KEDS po i implementon qytetin e Ferizajt. Në mbarë Kosovën, përgjatë këtij viti, sipas planit investiv, pritet të realizohen 250 projekte.

## Theksohen marrëdhëniet e mira bilaterale mes Kosovës dhe Holandës

Prishtinë, 29 gusht - Kryeministri Albin Kurti ka pritur në takim ambasadorin e re të Holandës në Kosovë, Karin Boven.

Në këtë takim të parë mes tyre, kryeministri e uroi për detyrën e re, teksa e falënderoi për mbështetjen e vazhdueshme dhe kontributin e Holandës ndaj

Kosovës në çlirim e zhvillim dhe për mbështetjen në anëtarësimin në Këshillin e Evropës. Ai shtoi se Kosova synon të bëhet anëtare edhe e BE-së dhe NATO-s duke iu bashkangjitur Holandës dhe shumë shteteve të tjera aleate e partnere.

Së bashku, kryeministri dhe ambasadorja theksuan marrëdhëniet e mira

bilaterale mes Kosovës dhe Holandës dhe angazhimin për thellimin e forcimit e mëtejshme të tyre. Kryeministri Kurti e njohu ambasadorin me progresin socio-ekonomik e demokratik të vendit, i cili është dëshmuar në tri vitet e fundit dhe nga indikatorët, matjet e rankimet pozitive ndërkombëtare.





## Haradinaj: AAK-ja bashkë me partnerët e koalicionit do ta nxjerrë Kosovën nga regresi

Prishtinë, 29 gusht- Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka vazhduar

takimet me kryetarët e degëve të partisë, me qëllim të harmonizimit të aktiviteteve parazgjedhore.

Ai ka thënë se Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me partnerët në koalicion, do ta nxjerrë Kosovën nga regresi

për ta bërë të mundshëm kthimin e perspektivës për zhvillim dhe integrimin euro-atlantik.



## Kurti: Po përgatitemi për gërmim në Kozhle të Serbisë në kërkim të të zhdukurve

PRISHTINË, 29 GUSHT- Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë me dije të enjten se kanë filluar përgatitjet për gërmime në lokacionin Kozhle në Serbi, në kërkim të personave të zhdukur gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Ai i ka bërë këto deklarata në një debat të dedikuar për personat e zhdukur me dhunë gjatë luftës së viteve 1998/99 në Kosovë.

Duke folur për përgatitjet për gërmim në Kozhle, ai ka thënë se shpreson që kjo "nuk është një përpjekje e re nga shteti serb për të evituar nga agjenda e gërmimeve lokacionet e tjera të shënuara nëpër Serbi". "Nuk ka kufomë, nuk ka krim, ishte strategjia e Serbisë për fshehjen e krimeve të kryera mbi shqiptarët në Kosovë. Kjo strategji vazhdon të zbatohet edhe sot nga trashëgimtarët politikë të [ish-liderit serb, Slllobodan] Millosheviqit në Beograd", ka thënë Kurti.

Ai ka bërë thirrje edhe një herë që

Serbia t'i hapë arkivat shtetërore.

Kurti ka thënë se Kosova ka bërë kërkesa zyrtare për hapjen e arkivës së Brigadës 37 të motorizuar të ushtrisë jugosllave, "përgjegjëse për shumë masakra në Kosovë, sidomos në Drenicë".

Ai ka përmendur se Serbia obligohet për hapje të arkivave edhe përmes një marrëveshjeje të arritur për këtë çështje, më 2 maj të vitit të kaluar në Bruksel.

Zotimet e bëra mes Kosovës dhe Serbisë në Deklaratën e përbashkët për personat e zhdukur përfshijnë: qasje të plotë në informacione të besueshme, mes tyre edhe ato me status të klasifikuar; vënie në dispozicion të të gjitha dokumenteve me rendësi për përcaktimin e fatit të personave të zhdukur, si dhe punë të përbashkët përmes një komisioni të kryesuar nga Bashkimi Evropian.

Deri më tani, gjithçka ka mbetur në letër.



Kurti ka thënë se Qeveria është e përkushtuar për trajtim të secilës informatë që kontribuon në zgjidhjen e rasteve të personave të zhdukur.

Sipas tij, tashmë janë adresuar 13 lokacione brenda territorit të Kosovës "në kuptim të gërmimit vlerësues". "Familjet e të

zhdukurve i kemi lart edhe mes prioriteteve e në përkujdesje të Qeverisë", ka thënë mes tjerash Kurti.

Gjatë luftës së fundit në Kosovë më 1998-99 janë vrarë më shumë se 13.000 civilë dhe mijëra të tjerë janë zhdukur.

Sipas Komitetit Ndërkombëtar të

Kryqit të Kuq, në Kosovë vazhdojnë të jenë të pagjetur edhe 1.612 persona, pjesa më e madhe e tyre shqiptarë.

Dita e të Pagjeturve në Kosovë shënohet më 27 prill, ndërsa më 30 gusht shënohet Dita Ndërkombëtare e Viktimave të Zhdukjeve me Forcë.

## Gjyqtari Hasan Kryeziu caktohet nënkryetari i Gjykatës Komerciale



PRISHTINË, 29 GUSHT - Me propozim të kryetarit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Mahir Tutuli, Këshilli Gjyqësor i Kosovës në mbledhjen e 331, ka caktuar gjyqtarin Hasan Kryeziu nënkryetar të Gjykatës Komerciale.

Gjyqtari Hasan Kryeziu është caktuar nënkryetar i Gjykatës Komerciale, me mandat të njëjtë sikurse mandati i kryetarit të Gjykatës Komerciale.

Në rolin e nënkryetarit, Kryeziu do të mbështesë kryetarin e gjykatës në përmbushjen e përgjegjësisë institucionale, duke promovuar standardet më të larta të profesionalizimit dhe etikës gjyqësore.

Hasan Kryeziu është gjyqtar në Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike në Gjykatën Komerciale.

Gjyqtari Kryeziu ka diplomuar në Fakultetin Juridik në Universitetin w Prishtinës në vitin 2014. Praktikën profesionale e kreu në Gjykatën Themelore në Prishtinë deri në vitin 2015, ndërsa provimin e jurisprudencës e ka përfunduar në vitin 2016. Nga viti 2016 deri në vitin 2018, ka punuar zyrtar ligjor në Gjykatën Themelore në Prishtinë përmes programit të USAID-it - Checchi Consulting and Co.

Nga gushti i vitit 2018 ka ushtruar pozitën e bashkëpunëtorit profesional në një avokaturë në Prishtinë, për të kaluar më pas si jurist për përfaqësim në KEDS sh.a. Hasan Kryeziu më 18.01.2021 është emëruar gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjakovë - Dega në Malishevë, ndërsa më 23.06.2022 është emëruar gjyqtar në Gjykatën Komerciale të Kosovës.

## Osmani priti në takim lamtumirës shefin e misionit të OSBE-së

PRISHTINË, 29 GUSHT - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të enjten në takim lamtumirës shefin e misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë, ambasadorin Michael

Davenport. Në takim, presidentja Osmani ka vlerësuar angazhimin e ambasadorit Davenport në krye të OSBE-së në mbështetje të përpjekjeve për forcimin e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit, për të cilat

Kosova po tregon progres të vazhdueshëm.

Me rastin e përfundimit të mandatit të tij, presidentja e falënderoi ambasadorin për punën e deritanishme në Kosovë dhe në të njëjtën kohë i ka uruar sukses në angazhimet e tij të mëtejshme.





## Kur ministri i Punëve të Brendshme bëhet "xehetar"



### Shkruan: Ferat SHALA

Pas skandalit të ditëve më parë, ku ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla u pa duke ndërhyrë në punën e një ndërmarrje publike, ku publikisht kërkonte llogari nga minatorët për dështimet që vetëm të minatorëve nuk janë, i njëjti sot me pompozitet pretendon se ka adresuar kërkesat e kësaj ndërmarrje me

një Udhëzim Administrativ i cili vetëm kërkesat e Trepçës nuk i adreson.

Krejt kjo për qëllime elektorale dhe me synim që të sanoj dëmet apo më mire të themi të arrij një kërkim falje të munguar.

Udhëzimi Administrativ i nënshkruar nga ministri i MPB-së është i kundërligjshëm dhe në mënyrë arbitrare cenon kompetencat e një Institucioni të Pavarur Kushtetues që është Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM). Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 06/2024 për Edukimin, Kriteret e Kualifikimit Profesional dhe Programet për Trajnime Profesionale është i kundërligjshëm dhe në kundërshtim me nenin 11

paragrafin 8 të Ligji Nr. 04/L-022 për Përdorim Civil të Eksplozivëve i cili përcakton se: "Leja e lëshuar nga ministria për përdorim të eksplozivëve sipas këtij ligji nuk e përfshinë lejen për minim për përdorim në miniera dhe gurore e cila është përgjegjësi e KPM-së, sipas Ligjit për Miniera dhe Minerale".

Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 06/2024 ka shfuqizuar Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 08/2013 për Edukimin, Kriteret e Kualifikimit Profesional dhe Programet për Trajnime Profesionale, i cili në nenin 1 që rregullon Qëllimin e UA, kishte përcaktuar se: "Ky Udhëzim Administrativ nuk mbulon kualifikimet e shpërthyesve industrial apo

persona të tjerë të kualifikuar në fushën e përdorimit të eksplozivëve për qëllime të minierave, e cila është përgjegjësi e KPM-së".

Udhëzimi Administrativ paraprak në këtë aspekt në pajtim me Ligji Nr. 04/L-022 për Përdorim Civil të Eksplozivëve kishte përcaktuar se kjo përgjegjësi i takonte KPM-së.

Në esencë MPB-ja dhe ministri Sveçla pretendon se ka adresuar kërkesat e Trepçës me një paragraf të fshirë të Udhëzimit Administrativ në kohë rekorde. Kjo qasje e qeverisë tregon joseriozitetin dhe mungesën e dijenisë si në aspektin ligjor ashtu edhe profesional, dhe paraqet një tendencë të qartë për cenimin e kompetencave të

organeve profesionale dhe të pavarura siç është Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale krejt kjo në llogari të sektorit të minierave.

Për më tepër nëse ky Udhëzim Administrativ zbatohet i njëjti paraqet rrezik në aspektin e sigurisë sepse i njëjti përcakton se provimi profesional mbahet nga një komision i brendshëm i MPB-së të cilët nuk janë profesionist të fushës së xehetarisë kjo kompetencë do duhej ti takonte vetëm inxhinierëve të xehetarisë me përvojë në këtë lëmi.

Kjo ndodh kur ministri i Brendshëm orvatet të bëhet edhe xehetar, e kur Bordi i KPM-së me apo pa vetëdije humb kompetencat e KPM-së dhe pranon ta shkelë ligjin!

## Nënshkruhen kontratat me përfituesit nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2024

PRISHTINË, 29 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, mori pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të kontratave me përfituesit nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB 2024), organizuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal.

Para të pranishmëve në këtë ngjarje, kryeministri Kurti shprehu kënaqësinë që ishte sot në mesin e tyre, në ceremoninë e kësaj iniciative e cila përkrah bizneset vendore, sipërmarrësit e rinj, të rejtat e të rinjtë të vendit tonë, për të ngritur dhe zhvilluar aktivitetet e tyre.

Kurti ka theksuar se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar që të mbështesë sektorin privat, i cili është një faktor i rëndësishëm i punësimit dhe i



rritjes ekonomike në vend tonë. "Krahasuar me vitin 2022, tash që po flasim në vitin 2024, Bruto Produkti Vendor është për 1/3 më i lartë, ndërkaq buxheti shtetëror vjetor është për 35 për qind më i lartë. Sigurisht që kjo është përkthyer

edhe me punësim të shtuar, krahasuar me para tri viteve në Kosovë është rritur punësimi për 20 për qind përfshirë këtu dyfishimin e të rinjve të punësuar. E padyshim që kjo ka ndikuar edhe në rritjen e fitimit dhe zgjerimit të aktivitetit të

sektorit privat. Vitin e kaluar, për zbatimin e masës 2.2 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, përkatësisht mbështetjes së bizneseve për qasje në financa, kemi ndarë 5.5 milionë euro për bizneset mikro, të vogla dhe të mesme. Edhe bizneset ishin të përfshira në skemat e gjera të shpërndarjes së rritjes ekonomike, në mënyrë të barazpeshuar, tek të gjithë pa dallim, por edhe për t'i përkrahur në sfidat globale me të cilat po përballemi", u shpreh kryeministri.

Në vijim tha se ndërmarrja e iniciativës së Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar, ka për qëllim zhvillimin socio-ekonomik të barabartë, përmes krijimit të vendeve të reja të punës, e rritjes së bizneseve të reja e prodhuese. "Sepse, teksa

prodhojmë vetë, nxisim produktivitetin e rivitalizojmë prodhimet e bizneset tona, jo vetëm së brendshmi, por edhe për të eksportuar e depërtuar në tregje edhe më të mëdha e ndërkombëtare. Të inkurajojmë të rinjtë e të rejtat, sipërmarrësit e rinj, bizneset e vogla e të mesme, për t'u rritur më tej e për të kontribuar pozitivisht në jetën ekonomike e në progresin shoqëror të vendit tonë", shtoi kryeministri.

Përfituesve të programit, kryeministri iu uroi suksese në vijim, e punë të mirë e të mbarë në zbatimin e projekteve edhe në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal. Nënshkrimi i kontratave u bë nga ana e ministrit të MZHR-së, Fikrim Damka me përfitues nga shtatë rajonet zhvillimore.

## Hapet dega e Postës së Kosovës në Mitrovicë të Veriut

PRISHTINË, 29 GUSHT - Posta e Kosovës e ka hapur të enjten degën e saj të parë në Mitrovicë të Veriut.

Zyrtarë të lartë të Qeverisë së Kosovës, ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, dhe ai i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, kanë marrë pjesë në hapjen e kësaj dege, në orët e hershme të mëngjesit.

Disa aktivistë dhe përfaqësues të partisë politike, Demokracia Serbe, kanë protestuar kundër hapjes së kësaj dege.

Ministrja Rizvanolli ka thënë se Posta e Kosovës synon të ofrojë shërbime postare për të gjithë, në të gjitha anët e Kosovës, dhe

se pika e hapur është e nënta që hapet në veri të vendit. "Është shumë e rëndësishme që kjo zyrë është hapur sot këtu dhe qytetarët e Mitrovicës së Veriut tani kanë mundësinë të vizitojnë këtë degë dhe t'i kryejnë të gjitha shërbimet që ofron kjo degë. Ka shërbime postare dhe të Telekomit", ka thënë ministri Krasniqi para mediave.

Hapja e kësaj dege vjen pas mbylljes së nëntë degëve të Postës së Serbisë në veri të Kosovës, pas informacionit të siguruar nga Autoriteti Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare (ARKEP) se ato degë kanë

vepruar jashtëligjshëm në territorin e Kosovës.

Mbyllja e këtyre degëve të Postës së Serbisë është dënues nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian, dhe është vlerësuar si hap i njëanshëm prej autoriteteve të Kosovës.

Në degët e kësaj Poste, qytetarët kanë marrë ndihmat që ndan shteti i Serbisë për ta - pensionet dhe shtesat për fëmijë - si dhe kanë mundur të kryejnë shërbime tjera postare.

Posta e Kosovës ka vepruar si njësi biznesi në kuadër të Telekomit të Kosovës deri më 2021, kur me vendim të Qeverisë së Kosovës është themeluar si ndërmarrje publike qendrore.





# Në rrënjët e Kamalës



Ishte 27 nëntori 2002, dita në të cilën Castro, një lagje simbol e komunitetit homoseksual të San Franciskos, organizoi homazhe për Harvey Milk, një nga politikanët e parë homoseksualë të zgjedhur në Shtetet e Bashkuara, i vrarë në vitin 1978 në bashkinë e qytetit. Në përvjetorin e njëzet e katërt të asaj ngjarje traumatike, qindra njerëz u mbledhën në sheshin Harvey Milk në orët e vona të pasdites.

“Kamala Harris qëndronte pranë meje,” thotë Patrick Cosson, një konsulent marketingu, i cili gjithashtu mori pjesë në përkujtimore atë vit, si gjithmonë. Zvpresidentja aktuale kishte veshur një kostum të zi dhe çizme kamoshi. Ajo vinte nga zyra juridike e bashkisë, ku drejtonte departamentin që merrej me familjet dhe fëmijët. “Shkëmbyem disa fjalë,” kujton Cosson. Në atë kohë, Harris nuk ishte ende avokate e San Franciskos – një pozicion i zgjedhur me votë – por po mendonte për të kandiduar në nëntor 2003.

Në atë kohë, ajo po ndërtonte rrjetin e saj të kontakteve në shoqërinë e lartë të San Franciskos dhe po u vardisej përfaqësuesve të “parave të vjetra”, domethënë trashëgimtarëve të aseteve bankare dhe naftës në qytet. Këto ishin vitet në të cilat nisën të shfaqeshin pasankët e rinj të

sektorit të teknologjisë në qytet. Revista Nob Hill Gazette publikonte rregullisht foton e Harris në mesin e njerëzve më me ndikim të San Franciskos. Në një nga ato imazhe, që daton në vitin 2000, Harris kishte veshur një kostum Burberry dhe titulli vlerësonte “elegancën e saj mahnitëse”. Atë ditë të vitit 2002, Cosson e këshilloi Harrisin të afrohej në skenën ku ndodheshin politikanët dhe personalitetet më të spikatura. Harris u kthye, ngriti gishtin tregues dhe iu drejtua në një mënyrë kërcënuese, e indinjuar nga ideja për ta përdorur atë ngjarje për qëllime elektorale. “Dëgjo,” tha ajo, “unë kam bërë fushatë për të drejtat civile që kur isha fëmijë. Nëna ime gjithmonë më ka shtyrë të marr pjesë dhe të dëgjoj, dhe këtë po bëj edhe bëj sot”. Njëzet vjet më vonë, kjo vendosmëri i prin kandidaturës së saj për presidencën e Shteteve të Bashkuara. Kamala Harris “nuk ka frikë të ngjallë frikë”, thotë Patrick Cosson.

Sipërmarrësi e tregon anekdotën nën flamurin ylber që ka dominuar në hyrje të lagjes që nga viti 1997. Është një ditë gushti me diell. Një fllad i ftohtë nuk i ndalon dy burra të shkulin një urdhëresë të qytetit të vitit 2012 – e mbështetur në gjykatë në vitin 2019 – që ndalon ecjen lakuriq në hapësira publike. Castro është një vend lirie, i papërkushëm nga konventat dhe një vend simbolik i atij San

Francisko të urryer nga konservatorët, të cilët e përshkruajnë atë si një metropol “radikal” larg nga pjesa tjetër e vendit: një koncept që e djathta do ta përdorë për të diskredituar kandidaturën e Harris, duke dashur që ajo të humbasë votat e votuesve më të moderuar në mid-west, një rajon zakonisht vendimtar në zgjedhjet presidenciale.

Shtetet e Bashkuara nuk kanë zgjedhur një president kalifornian që nga viti 1980, kur fitoi konservatori Ronald Reagan, dhe asnjë politikan i Partisë Demokratike nga shteti më i populluar dhe më i pasur në vend nuk ka arritur të fitojë ndonjëherë Shtëpinë e Bardhë. Sot në retorikën e Donald Trump dhe të djathtës, Kalifornia është një vend ku taksat janë të papërbalueshme, krimi është jashtë kontrollit, rrugët pushtohen nga njerëz që përdorin drogë dhe shkollat janë plot me transgjinjorë. Nëse Harris fiton, “Terroristët e Partisë Demokratike do të emërojnë qindra gjyqtarë të ekstremit të majtë për të imponuar me forcë vlerat e çmendura të San Franciskos mbi të gjithë amerikanët”, tha Trump më 27 korrik, gjatë një mitingu në Florida.

A do të jetë në gjendje Harris të heqë etiketën “radikale e Kalifornisë”? Kur pyet nëse është progresiste, e moderuar apo oportuniste, politikanët vendas

përgjigjen se ajo është centriste pragmatike. “Majtas qendrës”, specifikon Dan Morain i cili shkroi një biografi të titulluar “Në lidhje me Kamalën. Një jetë amerikane”. Rafael Mandelman, një këshilltar bashkiak i Partisë Demokratike, jep një lexim më me nuancua: “Harris është mjaft konservatore, por duke qenë se ajo vjen nga San Francisko, konsiderohet ende progresive”. Kamala Devi Harris është një produkt tipik i politikës kaliforniane: e rritur në zonën e Gjirit të San Franciskos, ajo iu afrua botës së Hollivudit falë bashkëshortit Doug Emhoff, një avokat në industrinë e argëtimit. Për të, politika është një çështje familjare. Ajo lindi më 20 tetor 1964 në spitalin Kaiser në Oakland, në anën tjetër të gjirit, gjatë periudhës së lëvizjes për fjalën e lirë (liria e shprehjes). Pesë kilometra larg spitalit, në Sproul plaza, studentët e Berkeley kishin demonstruar që nga mesi i shtatorit kundër kufizimeve të aktiviteteve politike në kampus. Edhe pse ka marrë pjesë në shumë protesta që kur ishte ende në karrocë, Kamala Harris e relativizon peshën e lëvizjeve, edhe për shkak se gjithmonë “ka dashur të ketë një rol brenda sistemit”, siç shkruante në autobiografinë e saj “Të vërtetat që ne mbajmë: një udhëtim amerikan”.

Harris është vajza e dy studentëve të huaj që ndiqnin ëndrrën kaliforniane në ato vite:

Donald Harris, xhamajkan dhe pasardhës i largët i një pronari plantacioni, kishte mbërritur në Berkeley në vitin 1961 me një bursë për doktoraturë në ekonomi; Shyamala Gopalan, indiane, vajza e një zyrtari të lartë nga Madras, ishte një studente e parakohshme, e cila në moshën 19-vjeçare, pas përfundimit të ciklit të parë të studimeve në Universitetin e Nju Delhit, arriti të pranohej në Berkeley, pa dajë dhe prindërve.

Ishte politika, në vjeshtën e vitit 1962, ajo që i bëri bashkë. Në atë kohë, Berkeley nuk ishte ende kryeqyteti i kundërkulturës, por protesta tashmë po mbinte dhe “Black Panther” po hidhte hapat e saj të parë. Në selinë e organizatës së studentëve afrikano-amerikanë, të rinjtë diskutonin për diskriminimin dhe dekolonizimin, duke lexuar autorë zezakë që nuk gjenin hapësirë në programet universitare. Një mbrëmje Donald Harris mbajti një fjalim mbi pabarazinë ekonomike dhe Shyamala Gopalan, iu afrua në fund të fjalimit. Më pak se një vit më vonë, në korrik 1963, ata u martuan.

## Formimi radikal

Spitali Kaiser në Oakland është shkatërruar, në vend të tij sot ka një parking. Ajo që ka mbetur nga fëmijëria e Kamala Harris është shtëpia në Bancroft Way,





ku nëna e saj u zhvendos pasi kërkoi divorcin në vitin 1971. Është një ndërtesë e verdhë njëkatëshe e rrethuar nga bimë yucca, të cilën komisioni bashkiak për ruajtjen e ndërtesave historike u përpoq ta mbronte në vitin 2021, përpara se të dorëzohej përballë banorëve.

Shkolla ndërkombëtare Montessori e cila zë katin përdhës ndalon hyrjen për vizitorët. Epoka e fjalës së lirë ka kaluar prej kohësh. Shkolla vetëshpallet “politikisht neutrale për të mbrojtur sigurinë e fëmijëve”, shkruhet në një tabelë të vendosur në parmakë.

Rreth ndërtesës lindi një lagje borgjeze e stolisur me manjola dhe akacie. Përpara strukturës ka një park bashkiak i projektuar për të “përmirësuar shëndetin e banorëve”, të shqetësuar për ndryshimet klimatike, thotë një tabelë e vendosur në hyrje. Shyamala kishte zgjedhur të jetonte në komunitetin e zezakëve, të cilët e kishin pritur me krahë hapur. Kamala dhe motra e saj Maya, e lindur në vitin 1967, u rritën midis Kishës Baptiste Afriko-Amerikane në Avenue 23 dhe Tempullit Hindu Livermore; ato dëgjonin “To be young, gifted and black” të Nina Simone (në versionin e kënduar nga Aretha Franklin) dhe këngët tradicionale të Indisë së Jugut, të cilat nëna e tyre i njihje mirë (ajo kishte fituar një çmim në një performancë muzikore të “Carnatic”).

Në vitin 1970, Kamala Harris ishte ndër studentët e përfshirë në programin e autobusëve, i krijuar për të kufizuar ndarjen racore midis shkollave: çdo mëngjes fëmijët nga lagjet e varfra çoheshin me autobus në lagjet e të bardhëve dhe anasjelltas. Dy botë që përplaseshin brutalisht. Kur Maya dhe Kamala shkuan në Palo Alto për të takuar babanë e tyre, i cili jepte mësim në Universitetin e Stanfordit,

fëmijët e lagjes refuzuan të luanin me to, me urdhër të prindërve. Në Berkeley dy vajzat zhyten në fermentin për të drejtat civile çdo të enjte në mbrëmje, në Rainbow Sign, në Grove Street, qendra kulturore e rinovimit intelektual të amerikanëve ngjyrë. Atje të rriturit dëgjonin Maya Angelou, Alice Walker ose James Baldwin ndërsa fëmijët uleshin në bibliotekë ose kuzhinë. Rreth asaj kohe, Harris kuptoi se “shprehja artistike, ambicia dhe inteligjenca ishin cool”, shkruan ajo në autobiografinë e saj. Vite më vonë, rruga Grove u bë Martin Luther King Jr., dhe sot Rainbow Sign strehon Qendrën e Shëndetit Mendor të qytetit të Berkeley.

Harris-it nuk i pëlqen të flasë shumë për origjinën e saj të ndërlikuar, por ajo flet shpesh për nënën e saj, shtatin e saj të shkurtër, theksin e saj, “të qeshurën e saj të brendshme” dhe vendosmërinë dhe sakrificat që i lejuan të të merrte një bursë dhe një vizë, pasi zbuloi se Shtetet e Bashkuara mirëpritën studentët nga vendet e dekolonizimit (babai i Barack Obamës, një kenian, kishte përfutur të njëjtin mundësi). Prindërit e lanë Shyamalën të largohej, por me premtimin se ajo do të kthehej dhe do të pranonte një martesë të ndërmjetësuar.

Në moshën 26-vjeçare, Shyamala Gopalan mbrojti tezën e doktoraturës në endokrinologji dhe lindi vajzën e saj të parë disa muaj më vonë. Në vitin 1976, Universiteti i Kalifornisë në Berkeley i mohoi promovimin, që ajo ishte e bindur se e meritonte, në favor të një burri. Kështu, Gopalan pranoi një pozicion në Universitetin McGill dhe u zhvendos me vajzat në Montreal, Kanada, një qytet frëngjishtfolës i mbuluar me dëborë për pjesën më të madhe

të vitit. Dhjetë vjet më vonë ajo u kthye në Kaliforni, ku u bë e njohur për kërkimet mbi rolin e receptorëve të hormoneve në zhvillimin e kancerit të gjirit. “Ajo nuk i kërkoi askujt leje për të ndjekur ëndrrat e saj”, shkroi vajza e saj, e cila nuk rri kurrë pa bërë homazhe për shkencëtaren, e cila vdiq në vitin 2009 për shkak të kancerit të zorrës së trashë.

Harris, megjithatë, flet rrallë për babanë e saj, një intelektual i krahut të majtë, i cili tani është 86 vjeç. Në fund të procedurave të divorcit, në vitin 1973, Donald Harris kishte fituar të drejtën për të kaluar gjashtëdhjetë ditë në verë me vajzat e tij. Me kalimin e viteve ai i çoi vajzat në Xhamajka dhe u shpjegoi “kontradiktat” e ekonomive të botës së tretë, ku mbivendosen varfëria dhe pasuria më ekstreme.

Në vitin 1972 Donald Harris ishte afrikan-amerikani i parë që fitoi një post profesori në fakultetin e ekonomisë në Stanford, edhe falë një peticioni nga studentët që kërkuan praninë e një mësuesi marksist në fakultet. Ndërhyrja e tij e fundit publike daton në vitin 2019, kur ai kritikoi vajzën e tij, një senatore në atë kohë, se pranoi që kishte pirë marijuanë. “Gjysma e familjes sime vjen nga Xhamajka”, ishte justifikuar me atë rast Kamala dhe Donald kishte shprehur bezdi për atë që ai besonte se ishte një stereotip për ishullin e tij të origjinës. “Stërgjyshërit tanë po kthehen përmbys në varret e tyre”, deklaroi ai. Që atëherë ka premtuar se do të qëndrojë larg “cirkut të politikës” dhe nuk do të bëjë më deklarata për mediat. Menjëherë pas marrjes së nominimit për Partinë Demokratike, Harris i telefonoi Amos Brownit, pastorit të Kishës së Tretë Baptiste, një nga kishat më të vjetra afrikan-amerikane në San Francisko. “Ajo më kërkoi të lutem për të, për burrin e saj

dhe për zgjedhjet”, tha Brown për revistën e krishterë Sojourners. “I thashë që t’i mbajë sytë tek objektivi.” Pastori, një student i Martin Luther Kingut, ishte mes të ftuarve në ceremoninë e inaugurimit të administratës Biden, organizuar më 20 janar 2021 në Uashington. Shtëpia e Bardhë kishte marrë me qira një aeroplan për të transportuar mysafirë nga Kalifornia, me një ekuipazh tërësisht femëror “me kërkesë të zëvendës-presidentes së zgjedhur”, shpjegoi komandanti.

Republikanët tashmë kanë filluar të analizojnë fjalimet e Brownit, siç bëjnë në vitin 2008 me Jeremiah Wrightin, pastorin e Barack Obamës, duke kërkuar deklarata të dyshimta për çështjen e racës. Më 4 gusht, në predikimin e tij, Browni kujtoi rolin e grave në Bibël. “Ne duhet t’i japim fund kësaj lufte kulturore kundër mundësisë që një grua të zgjidhet presidente e Shteteve të Bashkuara,” tha ai. Me një retorikë të ndërprerë nga duartrokitjet, pastori i ftoi besimtarët që “të jenë të gatshëm për t’u siguruar që Amerika është gati, gati sot, gati së shpejti, gati sa më shpejt të jetë e mundur për të mirëpritur një grua me ngjyrë që të udhëheqë vendin”.

### Nga Teksasi në Kaliforni

Kamala Harris hyri në lajmet e San Franciskos nga dera e pasme më 22 mars 1994, falë një artikulli të shkurtër nga Herb Caen, gazetari legjendar vendas. Caen, i cili punoi për më shumë se gjashtëdhjetë vjet për San Francisco Chronicle, kishte shkruar se gjatë festës për ditëlindjen e gjashtëdhjetë të politikanit Willie Brown, organizuar në kështjellën e milionerit Ron Burkle, afër Los Anxhelosit, aktori Clint Eastwood kishte derdhur një

gotë shampanjë mbi shoqen e Brown, Kamala Harris. Në atë kohë, Harris ishte 29 vjeçe dhe punonte si zëvendësprokurore në kontenë Alameda, në kufi me San Franciskon. Brown ishte lideri shumë i fuqishëm i shumicës demokrate në legjislaturën e Kalifornisë dhe askush nuk mund ta imagjinonte, që ajo grua një ditë do të ishte kandidate për presidente të Shteteve të Bashkuara.

Brown është një nga përbindëshat e shenjtë të politikës kaliforniane. Në vitin 1951, në moshën 17-vjeçare, ai u largua nga Teksasi për të kërkuar fatin e tij në Perëndim. Në San Francisko ai u bë avokat dhe mbrojtës i të varfërve dhe të marginalizuarve (në atë kohë firmat e mëdha ligjore nuk ishin në radhë për të rekrutuar një avokat afrikan-amerikan). Që nga viti 1960 ai ka marrë pjesë në çdo konventë të Partisë Demokratike. Ishte ai që ndihmoi Nancy Pelosi, kryetaren e ardhshme të Dhomës së Përfaqësuesve, të organizonte fushatën e saj të parë elektorale në vitin 1987 dhe ishte ai që lançoi Gavin Newsomin, guvernatorin aktual të shtetit, duke e detyruar atë të hynte në një komision mbi trafikun në bashkinë e San Franciskos. Qyteti pëlqen veshjet e tij italiane, Ferrarin e tij dhe batutat që bën.

Emri i Kamala Harris u rishfaq në gazeta më 29 nëntor 1994, në faqet e Los Angeles Times, kur gazetari Dan Morain zbuloi se Brown, u detyrua të linte postin e tij në legjislaturën e Kalifornisë (thuhet se ligjvënësit kishin vendosur limit në numrin e mandateve me objektivin e vetëm përjashtimin e tij), dhe kishte emëruar Harris në komisionin e mbikëqyrjes së kontratave me kompanitë e sigurimeve shëndetësore, me një pagë 72 mijë dollarë në vit.



Sipas Morain ishte hera e dytë që ai promovonte partneren e tij në atë kohë.

Harris, në fakt, kishte marrë tashmë një pozicion (të paguar 97 mijë dollarë në vit) në zyrën e papunësisë. Mes dhuratave të ndryshme të Brown për partneren e tij, ishte edhe një BMW.

Në atë kohë, politikani demokrat (i cili jetonte veçmas nga gruaja e tij, kishte disa të meta por nuk ishte divorcuar kurrë) ishte përfshirë në fushatën elektorale për t'u bërë kryebashkiak i San Franciskos. Harris dhe Brown morën pjesë në darkat së bashku në Pacific Heights, një lagje në modë me pamje nga Ura Golden Gate dhe ceremoninë e Oscarit në Hollywood. Një ditë, ndërsa ishte në Boston për një konferencë, Brown mori një ftesë nga Donald Trump, i cili donte të fliste me të për një projekt të pasurive të paluajtshme. Trump kishte dërguar avionin e tij privat për ta çuar në Nju Jork së bashku me bashkëpunëtorët e tij, përfshirë Harris. Gazetarët nuk kanë mundur asnjëherë të vërtetojnë nëse Harris ka marrë pjesë vërtet në takim, por është vërtetuar se kandidatja aktuale demokrate, ka udhëtuar në bordin e avionit të njeriut me të cilin do të përballet në zgjedhjet e 5 nëntorit.

Pas përfundimit të studimeve për drejtësi në San Francisko, Harris punoi në Prokurorinë e Qarkut Alameda. Duke habitur të gjithë ata që e kishin parë të rritej mes protestave në Berkeley, ajo nuk zgjodhi mbrojtjen e viktimave, por atë të ligjit. Ajo më vonë deklaroi se qëllimi i saj në atë kohë ishte humanizimi i sistemit të drejtësisë penale. Ndërsa ishte ende praktikante, Harris e kuptoi se sa shumë një person i vetëm mundej të sillte ndryshim. Ishte një mbrëmje e premtë – thotë ajo në biografinë e saj – dhe skuadra e antidrogës kishte arrestuar aksidentalisht një vajzë që ndodhej në shtëpinë ku po bëhej kontrolli. Ajo rrezikoi të qëndronte në paraburgim deri të hënën e ardhshme pa e ditur as nëse fëmijët eishin njoftuar për arrestimin. Me atë rast, Harris bëri gjithçka për të sjellë në gjykatë një gjykatës që mund ta lironte nga burgu. “Ishte një moment përcaktues në jetën time,” shkroi ai.

Në vitin 1998 ajo u emërua nga Terence Hallinan, një prokuror i San Franciskos, në krye të divizionit të çështjeve kriminale. Harris vendosi të transferohej në qendër të San Franciskos dhe të ndiqte këshillën e ish-mentorit të saj, Willie Brown (ata e kishin ndërprerë marrëdhënien romantike në dhjetor 1995) për të bërë atë që kishte rëndësi në San Francisko: afrimin me botën e shoqatave, të kulturës dhe bamirësisë. Harris iu bashkua bordit të drejtorëve të MoMA në San Francisko, një muze prestigjioz i artit modern ku zhvilloi një program për të ndihmuar të rinjtë me prejardhje të varfër të zbulojnë

artin. Më vonë ajo iu bashkua shoqatës SF Jazz, drejtoi darkën vjetore të klientëve të orkestrës simfonike, drejtoi një organizatë kundër dhunës në familje dhe shërbeu në bordin e drejtorëve të Women count, një shoqatë për promovimin e grave në politikë. Në atë kohë, Nob Hill Gazette e vlerësoi aktivizmin e asaj gruaje të re dhe jashtëzakonisht magjepsëse.

### Pa frikë

Gjatë asaj kohe, zvpresidentja aktuale e Shteteve të Bashkuara ndërtoi një rrjet kontaktesh që e mbështet edhe sot. Zhvilluesi shumë i pasur i pasurive të paluajtshme Mark Buell e konsideroi “një socialiste me diplomë juridike”, por ndryshoi mendje pasi e takoi. Në vitin

përshkruajnë si të patrembur në misionin e saj për të vënë kriminelët pas hekurave ose për t'u përballur me bankat e mëdha. Që nga viti 2003, Harris ka demonstruar vazhdimisht vendosmërinë e saj. Ajo nuk hezitoi të kandidonte kundër ish-shefit të vet Hallinan, i cili u paraqit si prokurori më përparimtar në vend. Pasi punoi për dy vjet në shërbimin e tij, Harris i njihte shumë mirë problemet e prokurorisë: hetuesit ishin të pamotivuar dhe pa staf, nuk kishte sistem klasifikimi të dokumenteve dhe shkalla e dënimit ishte më e ulëta në Kaliforni (29 për qind, nga mesatarja shtetërore prej 67 për qind). Sfiduesi kryesor i Hallinan ishte Bill Fazio, i cili mbante pozicione shumë më konservatore.

e sulmuan atë gjatë asaj fushate për marrëdhënien e mëparshme me Willie Brown. Në vitin 1995, Brown festoi zgjedhjen si kryebashkiak i San Franciskos me një madhështi princërore, duke hipur në Rrugën e Tregut në një karrocë me kuaj përpara më shumë se njëqind mijë spektatorëve. Gjatë një debati mes kandidatëve të organizuar në një kishë në lagjen Noe Valley, rivalët e Harris e akuzuan për konfliktin e interesit që do të shfaqej në mënyrë të pashmangshme nëse do t'i duhej të hetonte aktivitetet e bashkisë. Në një qytet ku konkurrenca ishte e ashpër dhe politika thuhej se i ngjante “një përlëshje me grushte në një kabinë telefonike”, dy rivalët e Harris zbuluan se kjo grua ishte krejtësisht e aftë të jepte goditje


### Fushata denigruese

Pasi mori detyrën, Harris bleu kompjuterë për stafin e saj dhe prezantoi një sistem të ri për klasifikimin e rasteve. Hetuesit e prokurorisë kishin një llogari emaili shtatë vjet përpara punonjësve të departamentit të policisë. Harris vendosi të mos ndjekë penalisht prostitutat, por klubet që i shfrytëzonin ato, dhe krijoi një program për t'i rikthyer njerëzit me precedentë kriminalë në rrugën e duhur – i quajtur “Kthehu në rrugën e duhur” – i cili më vonë u miratua në shumë qytete të tjera anembanë vendit. Gjatë katër viteve të para të mandatit të saj, shkalla e dënimit u rrit në 67 për qind, një rezultat mbi të cilin ajo bazoi ofertën e saj për rizgjedhje, por të cilin organizatat anti-raciste nuk ia falën kurrë.

Në nivel politik, episodi vendimtar i karrierës së Harris mbetet ndeshja e saj me sindikatat e policisë, vetëm tre muaj pas marrjes së detyrës. Gjithçka filloi më 10 prill 2004, kur Isaac Espinoza, një oficer policie 29-vjeçar, u vra në lagjen Bayview. Besnike ndaj premtimeve të bëra gjatë fushatës elektorale, Harris vendosi të mos kërkonte dënimin me vdekje për djalën që kishte qëlluar, duke nxitur zemërimin e policëve, të cilët ndiheshin të tradhtuar dhe të shumë politikanëve, përfshirë disa demokratë. “Ajo ishte nën presion të madh,” kujton Mandelman. “Por ishte në gjendje të rezistonte dhe të mbante premtimin, duke demonstruar karakter të madh”. Harrisit iu deshën dhjetë vjet si prokurore për të rregulluar përçarjen me sindikatat e policisë.

Gjatë gjithë karrierës së saj, Harris ka qenë subjekt i fushatave të ndryshme shpifëse të organizuara nga republikanët, pothuajse gjithmonë të fokusuar në marrëdhënien e saj me Willie Brown. Kandidatja për Shtëpinë e Bardhë asnjëherë nuk i është përgjigjur drejtpërdrejt akuzave dhe në autobiografinë e saj nuk e përmend asnjëherë emrin e ish-kryebashkiakut të San Franciskos. Pasi ka mbushur 90 vjeç, Brown vazhdon të qetësojë në mënyrë elegante sulmet. Pasi Harris u vendos në politikën kombëtare, ai tha se ishte i përgatitur për më të keqen. “Ka premtuar se do të më dënonte edhe nëse kaloj rrugën larg vijave të bardha,” tha ai për San Francisco Chronicle në vitin 2019. “Ajo do të më dëbojë nga vendi,” tha ai me ironi në një intervistë të botuar më 31 korrik 2024 nga Politico ndërsa fotot që i shfaqnin së bashku në vitet nëntëdhjetë qarkulluan në rrjete sociale. Brown, në çdo rast, gjithmonë do të jetë në gjendje të mburret se ka parashikuar i pari, që një ditë Kamala Harris do të mbërrinte në dyert e Shtëpisë së Bardhë.

Le Monde – Bota.al



2003, kur Harris vendosi të kandidonte për prokurore në San Francisko, Buell u bë arkëtar i fushatës. Ndërkohë që po takohej me elitën e San Franciskos, Harris krijoi selinë e saj në lagjen e zezakëve dhe hispanikëve të Bayview, larg dritave të ndritshme të qendrës së qytetit. Basti doli i suksesshëm, sepse falë mbështetjes multikulturore, Harris arriti fitoren e saj të parë dhe u fut në rrugën që do ta çonte të kandidonte për në Shtëpinë e Bardhë. Edhe sot ajo pretendon se dëshiron të bashkojë realitete që janë të kundërta: mbledh shuma rekord duke shfrytëzuar kontaktet e saj në institucione dhe në të njëjtën kohë, gjatë mitingjeve, përsërit fjalët e epokës së Black Power: nuk ka kthim prapa, nuk ka kthim mbrapa.

Nëse Barack Obama kultivoi “guximin e shpresës” (titulli i librit të tij të dytë), Kamala Harris pretendon një angazhim jashtëzakonisht konkret. Reklamata e saj të fushatës e

“Ishte një betejë mjaft tradicionale midis dy linjave të mendimit mbi krim: shtypja maksimale kundrejt shtypjes minimale,” thotë juristi Rafael Mandelman, aktualisht këshilltar i qytetit të San Franciskos. “Më pas erdhi kjo grua intriguese, e cila doli nga hiçi dhe ishte në gjendje të ndryshonte debatin.” Kamala Harris propozoi një politikë inteligjente kundër kimit. “Mesazhi i saj ishte: “Le të përpiqemi të kuptojmë se çfarë funksionon, të gjejmë mënyra për të riintegruar njerëzit me precedentë kriminalë në shoqëri dhe për të ulur shkallën e recidivizmit”. Mandelman thotë se një ditë e çoi kandidaten në një bar homoseksualësh. Ishte “nata e veshjes vetëm me të brendshme”, thotë ai, por ai mjedis transgresiv nuk e ndaloi Harrisin të diskutonte politikën sikur të gjithë të ishin me kostume dhe kravata. “Që në fillim m'u duk e qartë se askush nuk mund ta ndalonte”, thotë këshilltari.

Siç pritej, kundërshtarët e Harris

të ulëta. Në vend që t'u përgjigjej insinuatave, Harris u ngrit dhe filloi të fliste ndërsa lëvizte pas dy kandidatëve, duke kujtuar të gjitha rastet kur ata kishin vënë në shënjestër njëri-tjetrin: njëri ishte arrestuar në një sallon masazhi, ndërsa tjetri nuk kishte marrë masa kur dy magjistratë u kapën në flagrancë për kryerjen e një krimi për “sjellje të pahijshme” në gjykatë. Harris e përfundoi fjalimin e saj, duke qëndruar në qendër të skenës mes dy burrave dhe duke deklaruar: “Unë premtoj se nuk do të përdor kurrë të njëjtën strategji kundër kundërshtarëve të mi”. Publiku duartrokiti. Mediat u impresionuan. San Francisco Chronicle botoi një editorial të titulluar: “Harris, për ligjin dhe rendin”. Me një intuitë të përsosur, fushata e saj zgjedhore transmetoi një reklamë që tregonte foto të dhjetë prokurorëve të San Franciskos që ishin alternuar që nga viti 1900, të gjithë burra të bardhë. “Është koha për një ndryshim,” thoshte sloganin.





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Fetahu pritet ta marrë edhe një tjetër mandat në krye të FBK-së

PRISHTINË, 29 GUSHT - Arben Fetahu pritet ta marrë sot (e premte) edhe një tjetër mandat në krye të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK). Kryetari aktual nuk do të ketë kundërkandidat në Kuvendin e Rregullt Zgjedhor të FBK-së, i cili do të mbahet sot (e premte) nga ora 17:30 në hotel

“Emerald” në Prishtinë. Shtëpia e basketbollit kosovar i ka përmendur edhe pikate rendit të ditës, të cilat do të nisin me zgjedhjen e trupave punues, për të vazhduar me zgjedhjen e Kryesisë së Punës, Komisionit Verifikues dhe Procesmbajtësit. Më pas do të bëhet aprovimi i

procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Punës të datës 13.03.2024, do të bëhet prezantimi i kandidatit për kryetar të FBK-së, do të votohet kryetari i ri i FBK0së, do të votohen anëtarët e Bordit të FBK-së dhe do të votohen anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të FBK-së.



## Kosova për herë të parë pjesë e Lojërave Paralimpike

PARIS, 29 GUSHT – Kosova për herë të parë është duke marrë pjesë në Lojërat Paralimpike në Paris të Francës. Në Paris Kosovën është duke e përfaqësuar paraatleti Grevist Bytyqi, i cili do të garojë në atletikë. “Jemi krenarë që Grevisti po merr pjesë në një prej ngjarjeve më të mëdha të sportit global për persona me aftësi të kufizuara, ndërsa po bëhet inspirim për sportistët tjerë të vendit. I urojmë shumë suksese në garë”, ka bërë me dije ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku.

Pjesëmarrjen e Kosovës në këto lojëra, kryeministri Albin Kurti e ka vlerësuar si moment historik. “Kosova po shënon momentin historik në Lojërat Paralimpike, me pjesëmarrjen e saj të parë në këto gara. Flamurin e shtetit tonë në parakalim e barti me shumë krenari paraatleti ynë i vetëm, Grevist Bytyqi. Grevisti do të garojë të shtunën në garën e vrapimit 1 500 metra në kategorinë T46. Çdo hap i tij në këtë garë, le të jetë hap drejt suksesit tonë në sport dhe qasje gjithëpërfshirëse”, ka shkruar Kurti në “Facebook”.



## Ronaldo u përgjigjet kritikëve: Së pari dua t'i arrij 900 gola, më pas 1 000

RIAD, 29 GUSHT - Në një intervistë në kanalin e tij në “YouTube” me Rio Ferdinand, Cristiano Ronaldo, ka folur për objektivin e tij kryesor në karrierë: t'i arrijë 1000 gola.

Ylli portugez ka folur edhe indirekt për përballjen me Pelé e Romario, duke shpjeguar se si, në rastin e tij, për të dallim me legjendat tjera, ka edhe “prova” përmes videove për golat e tij. “Së pari dua t'i arrij 900 gola, më pas 1000. Por, me një diferencë: të gjithë golat e mi janë të filmuar, i kam provat”, ka deklaruar CR7, duke i “thumbuar” Pelen dhe Romarion.

“I respektoj të gjithë, por i kam provat. Nëse dëshiron, mund t'i sjell edhe golat që i kam shënuar



në stërvitje, nuk ka problem”, ka thënë Ronaldo duke qeshur. Edhe pse 39 vjeç, ish-futbollisti i Sporting Lisbonës, Manchester Unitedit, Real Madridit dhe Juventusit është ende i uritur për suksese, si në nivelin personal ashtu edhe në atë ekipor. “Dua të shënoj gjithmonë. Qoftë kundër Francës apo ndaj al-Etifaq, për mua nuk ndryshon asgjë. Pas një ndeshjeje të fituar, është edhe më mirë. Por, nëse shënoj më shumë, do të jem edhe më i lumtur. Dhe, pas humbjes kam mësuar se jeta vazhdon tutje”, ka nënvizuar pesë herë fituesi i Topit të Artë. Duke iu përgjigjur kritikëve, ai ka thënë: “Unë egoist? Mendoni se do të ndryshoj tash? ‘Cristiano është egoist, blah, blah, blah, po

mendoni se do të ndryshoj tash, kur jam gati 40 vjeç? Natyrisht që jo. Nëse të pëlqen apo jo, është pjesë e jetës. Nuk është një problem për mua”, ka thënë Ronaldo.

Ai ka folur edhe për Kombëtaren e Portugalisë, të cilën nuk e ka ndërmend ta lërë dhe duket se synon të marrë pjesë edhe në Botërorin 2026, kur do të jetë 41 vjeç.

“Sa i përket Kombëtares, njerëzit thoshin: ‘Është i mbaruar, është 39 vjeç, po vjetërsohet’. Por, përse? Sepse nuk e kam shënuar një gol. Por, çka të themi për të kaluarën? I kam shënuar 10 gola në kualifikime dhe shënova dygolësh ndaj Irlandës para Evropianit”, ka thënë Ronaldo.

## Bajrami drejt Skocisë, mesfushorin e do Glasgow Rangers

TIANË, 29 GUSHT - Nedim Bajrami pritët të jetë futbollisti më i ri i gjigantëve scokezë të Glasgow Rangers. Zbritja e Sassuolos në Serinë B ka ndryshuar planet e mesfushorit shqiptar, që ka

pasur oferta edhe nga ekipe të tjera italiane, por edhe nga Gjermania. Menaxherët e futbollistit 25-vjeçar pothuajse e kanë mbyllur marrëveshjen dhe pritët vetëm zyrtarizimi,

ndërsa trajneri i Glasgow Rangers, Filip Klement, ka pohuar në mediat lokale se klubi po negocion me mesfushorin kuqezi. Në karrierën e tij Bajrami ka luajtur me Sasuolon,

Empolin dhe Grasshoper. Ai pritët që të jetë shqiptari i dytë që vesh fanellën e skuadrës scokeze gjatë viteve të fundit, ndërsa në të kaluarën pjesë e këtij klubi ka qenë Eros Grezda.













## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales







# TRADITË QË NGA 1992

